

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), nenit 20, paragrafi 20.1, nënparagrafi d, nenit 21, paragrafi 21.2, dhe nenit 22, paragrafi 22.7, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2020, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE NË FONDET PENSIONALE DHE OFRUESIT E PENSIONEVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë kërkesën për shënimet minimale dhe mbajtjen e shënimeve të kontabilitetit në përputhshmëri me SNK.
2. Kjo Rregullore aplikohet për Fondet Pensionale dhe Ofruesit e Pensioneve që ofrojnë Pensione Plotësuese Individuale (“Ofruesi i Pensioneve”).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
  - 1.1. **Sistem kontabël** - nënkupton strukturën e organizuar të mbajtjes në mënyrë të kompjuterizuar të kontabilitetit, procedura dhe kontroll që të mbledhin, regjistrojnë, klasifikojnë, analizojnë, përmbledhin, interpretojnë dhe prezantojnë të dhëna të sakta dhe në kohën e duhur për vendimmarrjet e menaxhmentit;
  - 1.2. **Fiduciar** - nënkupton një person fizik ose person juridik që ka përgjegjësi ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve siç është përshkruar në kreun VI të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.

- 1.3. **Akt themelues i fondit pensional** – nënkupton dokumentin e shkruar juridik, i nënshkruar nga organi më i lartë qeverisës i punëdhënësit(ve), me të cilët themelohet fondi pensional si person juridik jofitimprurës në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.
- 1.4. **SNK** - nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e SIC-IFRIC lidhur me to, amendamentet e me pastajmë për këto standarde dhe interpretimet lidhur me to, si dhe standardet për të ardhmen sikur edhe interpretimet me to, të miratuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK);
- 1.5. **Shënimet e kontabilitetit** - përfshijnë ditarin e librave, librin kryesor, bilancin vërtetues dhe Pasqyrat Financiare të entitetit të pensionit.
- 1.6. **Plani kontabël** - nënkupton e llogarit që do të shfrytëzohen në klasifikimin e transaksioneve financiare dhe regjistrimin e transaksioneve.
- 1.7. **Ditari i librave** - nënkupton regjistrin ose librat kryesor që regjistrojnë me radhitje kronologjike transaksionet e kontabilitetit në regjistrime origjinale.
- 1.8. **Libri Kryesor** - përbëhet prej disa llogarive që regjistrojnë përmbledhjen e bilanceve të totaleve të llogarive të veçanta nga ditari i librave.
- 1.9. **Procesverbali** - nënkupton shënimet e mbledhjeve të bordit drejtues, komitetit të bordit drejtues, menaxhmentit, komiteteve të pensionit ose mbledhjeve tjera fiduciare.
- 1.10. **Bilanc vërtetues** - nënkupton një shënim të kontabilitetit që përmban përmbledhjen e të gjitha llogarive të librit kryesor të ndara në bilance të debisë dhe kredisë dhe /ose totalet.

### **Neni 3**

#### **Kërkesa për të mbajtur shënimet minimale të Fondeve Pensionale dhe Ofruesit e Pensioneve**

1. Fondet Pensionale dhe Ofruesit e Pensioneve duhet të përgatisin dhe mbajnë të siguruar siç duhet, shënime me shkrim që përmbajnë:
  - 1.1 Aktin e themelimit ose dokumentacionin ekuivalent të themelimit, statutin dhe të gjitha ndryshimet e tyre;
  - 1.2 Regjistrin e aksionarëve, duke përfshirë numrin e aksioneve të regjistruar në emër të secilit aksionar;
  - 1.3 Procesverbalet e çdo mbledhje të bordit të drejtues ose komiteteve të tij dhe vendimet e miratuara nga bordi i drejtues ose komiteteve të tij;
  - 1.4 Procesverbalet nga mbledhjet e aksionarëve dhe vendimet e miratuara nga aksionarët;
  - 1.5 Regjistrimet kontabël të cila tregojnë qartë dhe me saktësi gjendje e veprimtarisë së tij, duke sqaruar transaksionet dhe pozitën financiare të tij me qëllim që t'ia mundësojë BQK-së të vendos nëse institucioni ka vepruar në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e ligjit për fondet pensionale rregulloret, rregullat dhe urdhëresat në fuqi;

- 1.6 Të dhënat që tregojnë, për çdo kontribuues të fondit, në baza ditore, karakteristikat e transaksionit me ose në llogari të atij kontribuesi dhe bilancet për dhe nga ai kontribues;

#### **Neni 4**

#### **Mbajtja e shënimeve të kontabilitetit në përputhshmëri me SNK**

1. Fondet Pensionale dhe Ofruesit e Pensioneve duhet të ruajnë dhe te mbajnë në mënyrë komplete dhe të saktë:
  - 1.1 Shënimet e kontabilitetit duhet të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) me qëllim të sigurimit të paraqitjes së gjendjes së drejtë dhe të saktë të llogarive financiare.
  - 1.2 Llogaritë e konsoliduara duhet të paraqesin vlerën e drejtë dhe të saktë të aseteve, detyrimeve, pozicionit financiar dhe fitimeve ose humbjes në nivel të konsoliduar.
  - 1.3 Fondet Pensionale duhet të përgatisin pasqyrat financiare vjetore në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK), për të pasqyruar operacionet dhe gjendjen financiare të tyre, si dhe për të pasqyruar operacionet dhe gjendjen financiare të filialeve dhe degëve të tyre, si në baza individuale ashtu edhe në baza të konsoliduara.
  - 1.4 Llogaritë dhe pasqyrat financiare duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, duke reflektuar rregulla ose standarde shtesë të kontabilitetit siç përcaktohen nga BQK-ja.
2. Fondet Pensionale dhe Ofruesit e Pensioneve duhet të sigurojnë se shënimet e kontabilitetit regjistrojnë ose reflektojnë:
  - 2.1 Vlerat e kontributeve të pensioneve në lidhje me pjesëmarrësin aktiv ose pasiv së bashku me datën e transfereve dhe pasqyrimin e kontributeve të tilla, dhe burimin e kontributeve.
  - 2.2 Pagesat e përfitimit të pensioneve, dhe rifinancimet së bashku me datat e pagesave si dhe detalet e llogarisë së pranuesit të fondit të caktuar ose institucionin financiar.
  - 2.3 Investimet e mjeteve të pensioneve që regjistrojnë transferet e fondeve në ose prej entitetit të pensionit, për ose prej kujdestarit, menagjerët e mjeteve ose oficerët e investimeve duke përfshirë edhe fitimet nga investimet, dhe /ose fitimi i kapitalit.
  - 2.4 Ndalesat administrative dhe ngarkesat tjera financiare të aplikuara nga fondi pensional ndaj mjeteve të pjesëmarrësit për tu mbuluar shpenzimet e operimit.
  - 2.5 Pagesa e taksave për kujdestarin, menaxherin e mjeteve, dhe shërbimet tjera të palës së tretë pavarësisht se taksat e tilla a janë paguar nga Entiteti pensional ose Punëdhënësi Sponsorues i fondit pensional, ose ndonjë entitet ose person tjetër në emër të Entitetit të Pensionit të shoqëruar me shënimet e tilla që përfshijnë emrat dhe adresat e institucioneve ose personave të cilëve ju është bërë pagesa dhe arsyeja për pagesën e tillë.
  - 2.6 Pranimi i mjeteve që përfaqësojnë Transferin brenda Vlerës të pjesëmarrësve prej ish Fondit të tyre Pensional ose Siguruesit të pensioneve.
  - 2.7 Pagesat e mjeteve që përfaqësojnë Transferin jashtë vlerave të ish pjesëmarrësve për Fondin e ri Pensional ose Ofruesin e Pensionit.

- 2.8 Shënimet e pjesëmarrësve që përfshijnë: emrin , datëlindjen, numrin identifikues, përfituesin e caktuar, datën kur pjesëmarrësi i është bashkangjitur skemës, bilancet e llogarive individuale në pensionin me kontribut të definuar ose shënimet e shërbimeve të tij në pensionin me përfitim të definuar, dhe datën kur është larguar nga skema.
- 2.9 Çdo pagesë e bërë për Punëdhënësin Sponsorues në rast të Fondit Pensional dhe arsyeja për pagesën e tillë.
- 2.10 Pagesat e tjera të bëra nga Entiteti i Pensionit duke përfshirë emrat dhe adresat e institucioneve ose personave të cilëve ju është bërë ajo pagesë dhe arsyen për pagesën e tillë.
- 2.11 Çdo pranim i mjeteve për llogarinë e skemës pensionale, përveç kontributeve.

## **Neni 5**

### **Metoda e mbajtjes së shënimeve**

1. Shënimet e kërkuara sipas kësaj Rregullore duhet të mbahen në letër dhe format elektronik. Në secilin rast duhet të ketë siguri për të dhënat. Plani dhe procedurat e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, duke përfshirë arkivimin dhe kopjen rezervë të të dhënave në mënyrë që të sigurohet mirëmbajtja dhe siguria e të dhënave, duhet të jenë të miratuara, të rishikuara dhe përditësuara në baza të rregullta kohore.
2. Çdo shkallë e dëmtimit të të dhënave pa pasur mundësi që të rimëkëmben ose restaurohen duhet ti raportohet pjesëmarrësit dhe Punëdhënësit Sponsorues me anë të një njoftimi me shkrim brenda 10 ditëve që Bordi i drejtues ose menaxhmenti të jenë në njohuri me dështimin e rikthimit të të dhënave.

## **Neni 6**

### **Zbatimi, masat korrigjuese dhe dënimet civile**

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 7**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 26 e BPK-së mbi Mbajtjen e Shënimeve në Fondet Pensionale dhe Siguruesit e Pensioneve, e datës 17 prill 2003.

## **Neni 8**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e miratimit të saj.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Flamur Mrasori